

Shqipëria para Maqedonisë për investime

Deri më 48 për qind të anketuesve mendojnë se vendet fqinjë ofrojnë mundësi më të mira për investime. Burokracia e sistemit të gjykatës të përcjellura nga shërbimet kadastrale janë ende pengesë për biznesin në Maqedoni.



Maqedonia po i humb konkurrentët për tërheqjen e investitorve të huaj në lidhje me shtetet rajonale, tregojnë rezultatet e kërkimeve që i ka bërë Këshilli i investitorve të huaj me GFK.

Deri më 48 për qind të anketuesve mendojnë se vendet fqinjë ofrojnë mundësi më të mira për investime. Burokracia e sistemit të gjykatës të përcjellura nga shërbimet kadastrale janë ende

pengesë për biznesin në Maqedoni.

Mbi 40 për qind të anketuesve kanë dhënë përgjigje negative për klimën e biznesit në Maqedoni, por gjithashtu një përqindje e njejtë janë shprehur se nuk kanë shpresa për përmisimin e gjendjes ekonomike gjatë 12 muajve të ardhshëm.

Të anketuarit kanë përmendur Shqipërinë si destinacioni më i preferuar për investitorët e huaj, ndërsa pas saj vijnë Serbia dhe Bullgaria. Kërkimi është bërë në periudhën prej 15-17 qershor të këtij viti në bashkëpunim me GFK – Shkup

Kategoria: Lajme > Maqedoni

Publikuar: 01.07.2009 21:07

Burimi: <http://www.tvkoha.tv/1556/shqiperia-para-maqedonise-per-investime.html>
